



Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave

REAGIM ndaj keqtrajtimit të gazetares, Salie Gajtani

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës e ka pranuar me shqetësim të madh lajmin për keqtrajtimin e rëndë që është bërë ndaj gazetares së "KOHES Ditore" Salie Gajtani, nga ana e stafit mjekësor të Klinikës Gjinekologjike të QKUK-së, ku ajo kishte shkuar për të lindur fëmijën e tretë.

Ky grup "mjekësh dhe infermierësh" duke mos e kryer punën e tyre sipas kontratës dhe betimit të Hipokratit, e kanë sjellë buzë vdekjes gazetaren Gajtani dhe i kanë shkaktuar probleme të mëdha shëndetësore.

Ne konsiderojmë se sjellja joprofesionale e stafit të kësaj Klinike, ndaj gazetares Gajtani, përben një shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut dhe një vepër të rëndë penale.

Njëkohësisht shprehim indinjatë të thellë për mosreagimin nga ana e institucioneve të shtetit, të cilave gazetarja Gajtani iu ka drejtuar një letër të hapur, duke i njoftuar për krejt atë çfarë kishte ndodhur në Klinikën Gjinekologjike.

Kurse, gazetaren Salie Gajtani e inkurajojmë për guximin dhe vullnetin që të denoncojë publikisht këtë rast të rëndë. Ajo ka përkrahjen dhe mbështetjen e plotë të të gjitha grave intelektuale të shoqërisë civile të Kosovës deri në zbardhjen e plotë të këtij rasti dhe dënimin e atyre që gati e privuan nga e drejta elementare për jetë.

Shpresojmë që kjo do të ndikojë në vetëdijësimin e drejtuesve të institucioneve në marrjen e masave për ngritjen e cilësisë së shërbimeve në këtë Klinikë, si dhe në gjithë QKUK-në.

PRESS

www.womensnetwork.org • Hajdar Dushi St. C-2 II/8, 10000
Prishtina, Kosovo • +381 (0) 38 245 850 •
info@womensnetwork.org